

KONTRATË SHITJE

/të kuotës së Shoqërisë

Sot, më datë **14/06/2023**, u mbledhën palët dhe lidhën këtë kontratë shitje kuotash, si më poshtë vijon:

SHITËSI:

Z. **Ermir Ndreaj** atësia Rrustem , shtetas Shqiptar, lindur në Barjam Curri më 17.03.1981 dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit ID nr. 032927418 dhe nr. personal I10817062P.

DHE

BLERËSI:

Z. **Gentian Bruzja** atësia Ramazan, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë më 12.08.1979 dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit ID nr. 036841536 dhe nr. personal H90812039J.

PARAPRAKE


Objekti i kësaj kontrate është Shitja e kuotës të Shoqërisë "Unlimited Constructions" Sh.p.k nga ortaku Z. Ermir Ndreaj, në cilësinë e shitësit, i cili zotëron një kuotë me vlerë nominale të përgjithshme të barabartë me 100.000 (njëqind mijë) Lek që përfaqëson 100 % (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë "Unlimited Constructions" Sh.p.k dhe ja shet Z. Gentian Bruzja, në cilësinë e Blerësit.

BAZA LIGJORE

1. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;
2. Ligji Nr. 9901, datë 14/4/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare",
3. Ligji Nr.9723, datë 03/05/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit i Ndryshuar;

NENI 1- OBJEKTI I KONTRATËS

1.1 Shoqëria Tregtare "**Unlimited Constructions**" Sh.p.k me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me nr. NUIS **M21503006C**, me seli ligjore në Tiranë me adresë në kryqëzimin Blv Gjergj Fishta me Rr. e Kavajës, Njësia Nr. 7, rregjistruar me datë 02.03.2022, Shoqëria ka një kapital themeltar të regjistruar prej 100.000 (Njëqind mijë) Lekë, si më poshtë vijon:



Aktualisht kuotat në Shoqëri zotërohen si më poshtë:

1. **Z. Ermir Ndreaj**, zotëron një kuotë në masën 100 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë "Unlimited Constructions" sh.p.k. me vlerë nominale prej 100.000 (njëqind mijë) Lek.

1.2 Me **Vendimin e datës 14.06.2023 të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë** është vendosur nga Ortaku i Shoqërisë **Z. Ermir Ndreaj**, shitja e kuotës së tij në masën 100% dhe blerja e saj nga **Z. Gentian Bruzja** në masën 100% të kapitali të Shoqërisë.

1.3 Shitja në masën prej 100% të kuotës të kapitalit themeltar të Shoqërisë "**Unlimited Constructions**" **Sh.p.k** sjell humbjen e së drejtës së pronësisë nga ortaku i Shoqërisë **Z. Ermir Ndreaj**, si pasojë e këtij transaksioni shitjeje, shprehur edhe në vendimin e Asamblesë së Ortakëve, datë 14.06.2023.


1.4 Shitësi **Z. Ermir Ndreaj**, është plotësisht dakord të shesë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë 100% të kuotës që ai zotëron në Shoqëri, kuotë e cila do të shitet në favor të blerësit **Z. Gentian Bruzja** dhe si rrjedhojë blerësi do të zotëroje kuotën në Shoqëri në masën 100% të kapitalit themeltar.

1.5 Blerësi **Z. Gentian Bruzja**, është plotësisht dakord që të blejë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, masën prej 100% të kuotës të shitur të zotëruar nga shitësi në kapitalin themeltar të Shoqërisë tregtare "**Unlimited Constructions**" **Sh.p.k** duke përfutur pronësinë në masën prej 100% të kapitalit, me të gjitha të drejtat e detyrimet që sjell blerja e kuotës dhe duke fituar cilësinë e ortakut të vetëm të Shoqërisë "**Unlimited Constructions**" **Sh.p.k**

NENI 2- MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË TË KUOTËS

2.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitësi, ortaku i Shoqërisë **Z. Ermir Ndreaj**, humbet pronësinë përkatësisht në masën 100% të kuotës të zotëruar prej tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë "**Unlimited Constructions**" **Sh.p.k**, duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi kuotën e shitur dhe njëkohësisht edhe titullin ortak në Shoqëri. Ndërsa blerësi **Z. Gentian Bruzja**, bëhet pronar përkatësisht në masën prej 100% të kuotës të shitur, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart blerja e kësaj kuote dhe titullin ortak i vetëm shoqërisë "**Unlimited Constructions**" **Sh.p.k**.

2.2 Shoqëria Tregtare "**Unlimited Constructions**" **Sh.p.k**, pas realizimit të këtij operacioni shit-blerje kuotash, sipas kësaj kontrate, do të ketë si ortakë të saj me pjesërnarrje në kapitalin themeltar si më poshtë:



1. **Z. Gentian Bruzja**, ortak i vetëm i Shoqërisë zotëron një kuotë në masën 100 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë "Unlimited Constructions" sh.p.k, me vlerë nominale 100.000 (Njëqind mijë) Lek.

NENI 3- ÇMIMI I SHITJES SË KUOTËS

3.1 Si çmim i këtij transaksioni shitblerje kuotash të Shoqërisë "**Unlimited Constructions**" **Sh.p.k** do të jetë shuma prej 100.000 (njëqind mijë) Lekë, çmim i cili bazohet në vlerën nominale të kuotës sipas Statutit të Shoqërisë.

3.2 Sipas këtij përcaktimi, Blerësi **Z. Gentian Bruzja**, do të paguajë në favor të Shitësit **Z. Ermir Ndreaj** shumën në total prej **100.000 (njëqind mijë) Lek**, shumë e cila është paguar jashtë kësaj zyre dhe shitësi nuk do të ketë sot dhe në të ardhmen pretendime për këtë shumë

3.3 Palët në këtë kontratë kanë rënë dakord që pronësia e kuotave të kalojë në favor të blerësit me publikimin e kësaj kontrate në QKB.

NENI 4- LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

4.1 Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin civil shqiptar. çdo aspekt që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë kontratë do të dispijlinohet nga dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit "Për Shoqëritë Tregtare", në fuqi si dhe legjislacionit shqiptar në përgjithësi që mbulon dispijlinimin dhe interpretimin e kësaj kontrate.

NENI 5- ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

5.1 Në rast mosmarrëveshjeje rreth zbatimit dhe interpretimit të kësaj kontrate, palët bien dakord ta zgjidhin atë në rrugë miqësore. Në rast se kjo nuk është e mundur, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

PALËT

SHITËSI

Ermir NDREAJ

ERMIR NDREAJ



BLERËSI

Gentian BRUZJA

